



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština – Assembly**

---

**Legjislatura VIII**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr.100

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Prishtinë, më 24 shtator 2024, në orën 10:00

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë** : Fatmire Kollçaku, Armend Zemaj, Labinotë Demi- Murtezi, Haxhi Avdyli, Mirsad Shkreta, Burim Meta, Shemsedin Dreshaj dhe Samra Ilijazi,

**Munguan** : Bekim Haxhiu dhe Floretë Zejnullahu, anëtarë.

**Stafi mbështetës** : Shpresa Haxhijaj, koordinatore dhe Besim Haliti, zyrtar i lartë/analist.

**Pjesëmarrës tjerë** :Violeta Salihu – Emini nga KSHMS-ja .

**Mbledhjen** fillimisht në mungesë të kryetares se Komisionit znj. Fatmire Kollçaku, mbledhjen e kryesoi zëvendëskryetari i Komisionit z. Armend Zemaj.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor;**
- 3. Të ndryshme.**

**1.Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

**2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit Nr.08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor**

**Armend Zemaj**, tha se ky projektligj është i obligueshëm në bazë të Rregullores së Kuvendi që së pari të shqyrtohet në këtë Komision funksional, pa marr parasysh verdiktin që do ta merr ky projektligj në bazë të procedurave shkon në Kuvend për shqyrtim të mëtejme në lexim të parë në seancën plenare të Kuvendit.

**Haxhi Avdyli**, tha së tash më këtë projektligj e kemi infrastrukturën ligjore, e cila është vetëm një hapë për të filluar më grumbullimin e sigurimeve shëndetësore, projektligji i ka adresua të gjitha mangësitë të cilat kanë penguar që Kosova, deri më sot mos të ketë sigurime shëndetësor. Pasi miratimit të këtij ligji po e bëjmë një hap përpara drejt sigurimeve shëndetësore, pasi që nga viti 2014, ne kemi pasur të miratuar Ligjin për sigurimin shëndetësor, por fatkeqësisht nuk është filluar me grumbullimin e fondit të sigurimeve shëndetësore. Prandaj, besoj që ky projektligj i ka adresuar mangësitë edhe të ligjit të kaluar për sigurimin shëndetësor, ky projektligj është mbipartiake dhe besoj që në këtë drejtim do të kemi kontributin e të gjithë kolegëve sepse ky projektligj tejkalon edhe mandatet tona edhe qeverinë, besoj që pasi miratimit të këtij ligji do të jemi një hap përpara për ta filluar krijimin e fondit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

**Armend Zemaj**, theksoi se Projektligji për sigurimet e detyrueshme të kujdesit shëndetësor, është i vonuar dhe pa zgjidhje të qëndrueshme, dhe se i njëjti në përmbajtje nuk ofron zgjidhje të qëndrueshme. Më shumë është përgatitur për të mbuluar dështimin katërvjeçar të kësaj Qeverie në sektorin e shëndetësisë dhe ky projektligj nuk mund të improvizohet në fund të këtij mandati qeverisës sa për të përmbushur procedurën e agjendës legjislative të Programit të Qeverisë për vitin 2024, dhe tash është përgatitur për tu përdorur për fushatë zgjedhore. Koha nuk është sa për të improvizuar, por ne duhet të jemi shumë më serioz jo vetëm ta përdorimi për fushatë elektorale, pasi që ky ligj është etik dhe domosdoshëm për shëndetësinë e vendit. Andaj nuk duhet të veprohet më nguti sikurse që është vepruar më Ligjin e miratuar për sigurimin shëndetësor nga viti 2014, ashtu siç edhe ka të meta edhe sot ky ligj nuk është i zbatueshëm, prandaj në këtë drejtim duhet të kemi qasje më serioze në mënyrë që kur të aprovohet ky ligj të gjej zbatim në terren dhe praktik. Nuk është bërë asgjë për funksionalizimin e Sistemit Shëndetësor Informativ (SISH-it), që duhet të këtë ndërlidhje më zbatimin e këtij ligji dhe nuk e kemi Ligjin e ri për shëndetësi.

**Shemsedin Dreshaj**, tha që këtë projektligj e kemi pasur të propozuar në Programin Legjislativ të Qeverisë që prej vitit 2021, çdo vit ka qenë i paraparë në agjendën legjislative të vijë por që nuk është sjellë, pro tash është fundi i vitit të mandatit të kësaj Qeverie dhe përfundim i Legjislaturës së Kuvendit, është kohë e papërshtatshme për sjelljen e këtij Projektligji, prandaj do të mbesin veprimet vetëm në letër dhe nuk do të gjejë kurrfarë zbatimi, pas që projektligji ka ardhur vonë dhe nuk e ka kohë të mjaftueshëm që të amendamentohet siç e duhet, tani vetëm jemi ka fundi përfundimit të kësaj legjislaturë edhe në esencë ky është ligj i vjetër me gjashtë intervenime, nuk bëhet fjalë për një projektligj të ri. Ju e dini se për t'i realizuar sigurimet shëndetësor nevojiten minimumi katër vite që të grumbullohet ky fond dhe që të funksionalizohet ky proces. Ky projektligj me të gjitha premiset është i paraparë që të dështoj. Nuk ka pako bazike, nuk ka çmimore për shërbimet e mbështetura, nuk janë të definuar qartë kategoritë subvencionuara që duhet mbështetur e që në Kosovë ka mjaft, nuk është definuar kostoja dhe gama e shërbimeve shëndetësor që obligohen brenda sigurimit shëndetësor dhe nuk është bërë asgjë për sigurimin e parakushteve për të filluar më sigurimet shëndetësor. Mungesa e sigurimeve nuk arsyetohet me mungesë të ligjit por të vullnetit politik për të zbatuar edhe me këtë qeverisje ka dështua. Ai ka kërkuar që Projektligji të tërhiqet nga Qeveria pasi që nuk ka mbetur shumë pak kohë për ta trajtuar si duhet.

**Mirsad Shkreta**, tha se pajtohet së është e vonuar ardhja e Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, por edhe ne si Komision kemi qenë insistues vazhdimisht për të ardhur ky projektligj. Projektligj është i qartë edhe sa i përket krijimit të fondit për sigurimet shëndetësore. Ndërsa lidhur me mos funksionalizimin e Sistemit Shëndetësor Informativ, tha se nëse pritet ndërsa të funksionalizohet SISH-i, atëherë do të kemi edhe vonesa për fillimin e sigurimeve shëndetësore. Ai potencoi se mos funksionalizimi i Fondit të Sigurimit Shëndetësor

nuk është vetëm mungesë e vullnetit politik por edhe shkarje në procedurat ligjore që nga themelimi e deri tek tentativa për funksionalizim. Sot në këtë projektligj adresimi dhe mënyra se si adresohet themelohet ky Fond është ndryshe nga ligji paraparakë, andaj nëse ne vazhdojmë ta presim funksionalizimin e SISH-it, deri në fund, dhe nuk e procedojmë paralelisht edhe me ligjin, mendoj se do të jemi pengë derisa të funksionalizohet krejt sistemi informativ shëndetësor në jetësimin e formimit të sigurimeve shëndetësore.

**Labinotë Demi- Murtezi,** tha se shëndetësia është njëra nga fushat që duhet ta mbështesim të gjithë përjashtim dhe në këtë rast Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor. Jo çdo herë të gjitha ligjet që janë miratuar nuk kanë mundur të gjen funksionalizim, sepse janë të ndërlydhura ndërmjet veti, andaj uroi që ky projektligj të mos ketë fatin atyre ligjeve që pasi janë miratuar nuk janë të funksionalizuar. Ajo theksoi se periudha në mes të dy leximeve është koha që mund ta plotësojmë dhe ndryshojmë këtë projektligj, aty ku e konsiderojmë që nuk është rregulluar mirë për të gjetur zbatim në praktik, shpresoj që ky ligj pasi miratimit të tij do të funksionalizohet në tersi në zbatim.

**Haxhi Avdyli,** tha se është e vërtetë që kemi të miratuar Ligjin për sigurimin shëndetësor që prej vitit 2014, por fatkeqësisht asnjëherë, nuk kanë filluar të mbledhjen premiumet e fondit, andaj më këtë projektligj që ka ardhur tash nga Qeveria i cili është hartuar nga Ministria e Shëndetësisë ka shumë hallka që do të përmbushen, parashihet krijimi i Fondit për Sigurimet shëndetësor prej dy burimeve, ku shkalla e kontributit për llogari të fondit për sigurim të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor është 7% e pagës bruto, nga e cila 3.5% mbulohet nga punëdhënësi dhe 3.5% nga punëmarrësi. Ai potencoi se reforma në shëndetësi po merr një dinamizëm më të madh, besoj se pos Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, deri në fund të këtij mandati do të kemi Projektligjin për Shëndetësi edhe për Inspektoratin Qendror të Shëndetësisë të cilat do të e forcojnë reformën në shëndetësi në aspektin e funksionimit të sistemit tonë shëndetësor.

**Armend Zemaj,** sa i përket votës për ose kundër miratimit të këtij Projektligji, ne si grup parlamentar i LDK-se si opozitë këtë e kemi treguar më votimin e Projektligjit për çmimin e produkteve medicinale, dhe për këtë çështje është dëshmuar vota e jonë, mirëpo, ky ligj akoma nuk është duke u zbatuar. “Këtë proces nuk duhet të kthehet në tallje për qytetarët. Të sjellët projektligji në muajt e fundit të mandatit nuk është e drejtë. As nuk është koha e duhur për ta nisur e as përfunduar. Koha nuk është sa për të improvizuar, por ne duhet të jemi më seriozë e jo ta përdorim sa për fushatë zgjedhor”. Prandaj në këtë drejtim duhet të kemi qasje më korrekte që të kemi sigurime shëndetësore të zbatueshme dhe nuk i përmbushen mangësitë ligjore në këtë fushë nga qeveria që ka përgatitur këtë projektligj për të e mbuluar dështimin e tyre 4-vjeçar në qeverisje, andaj në përmbajtjen kohën kur është sjellë për shqyrtim në Kuvend si i tillë ky projektligj nuk duhet të kalojë.

**Burim Meta,** tha se miratimi i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, do ta bëjë të mundur edhe krijimin e Fondit për Sigurimet Shëndetësor që është nevojë imediate për rregullimin tonë shëndetësor, këtë gjë e dimë të gjithë, andaj sot e kemi një nismë pozitive që më anë të miratimit të këtij projektligji do të filloi së zbatuar edhe në praktikë grumbullimi i fondit të sigurimeve shëndetësore. Ai theksoi së krahas këtij projektligji do ta kemi edhe një katalog të shërbimeve shëndetësore dhe të çmimeve së çka ofrohet në pakon e këtyre shërbimeve. Kërkoj që ta japim kontributin tonë si Komision dhe ta kemi një unifikim pasi që në mes të dy leximeve kemi kohë të mjaftueshme që ta bëjmë të mirën e mundshme në mënyrë që pasi të miratohet ligji të gjejë zbatim.

**Shemsedin Dreshaj,** tha se ne si Komision në shumë rast të miratimit të projektligjeve e kemi qenë kompakt, por nuk duhet të bëhet fushatë zgjedhor më këtë ligj, sikurse që e dini së ne kemi

votuar edhe Projektligjin për çmimin e produkteve medicinale, tash janë bërë njëviti e gjysme që kur ky ligj ka hyre në fuqi, por ende nuk po gjen zbatim, andaj edhe ky ligj do të jetë shumë e vështirë që të përjetësohet në praktikë, sepse ka ardhur vonë në përmbajtjen e tij duhet kohë të amendamentohet. “Është e çuditshme pse pas katër viteve qeverisje sille të këtu, sikur ta kishim pasur në fillim të vitit 2021 vërtetë do të kishim dhënë kontributin tonë dhe ky projektligj me të gjitha premisat është i paraparë të dështoj. Ky ligj është i punuar në shpejtësi dhe paraqet substancën e ligjit të vjetër i cili është miratuar që nga viti 2014. Edhe ky ligj është i gjykuar në dështim pasi që parakushtet për implementim të suksesshëm të sigurimeve shëndetësore deri më sot nuk janë plotësuar nga kjo Qeveri”. Mirëpo, ky projektligj në bazë të procedurave më votën tonë apo pa votën tonë do të shkojë në seancën e plenare të Kuvendit për shqyrtim, ne do ta japim kontributin tonë nën për nen që ta përmirësojmë substancën e këtij projektligji.

**Haxhi Avdyli**, ka kërkuar mbështetjen edhe të partive opozitare për ta miratuar këtë projektligj, që duhet të proceduar për shqyrtim në seancë plenare të Kuvendit. Ai tha së gjatë periudhës në mes të dy leximeve, mund ta japin të gjithë kontributin e tyre dhe për vërejtjeje që u jepen për krijimin e pakos bazike të shërbimeve shëndetësore. Edhe për kundër që është vonuar ky projektligj, duhet vlerësuar se po hapet rruga e sigurimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët, edhe pse Kosova që prej vitit 2014 e ka pasur Ligjin për sigurimin shëndetësor, por deri tani ai nuk ka gjetur zbatim.

**Fatmire Kollçaku**, fillimisht kërkoi falje për vonese ardhjes në mbledhë për shkak të arsyeve të një sëmundje në familje. Ajo tha së ne kemi pasur të miratuar Ligjin për sigurimin shëndetësor prej vitit 2014, mirëpo, nuk është krijuar fondi për sigurime shëndetësor, ndërsa tash më ardhjen e Projektligjit të ri për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, parashihet dhe krijimi i këtij fondi, ku do të ju shërbej gjitha qytetarëve. Kërkoi që të votohet ky projektligji për të e proceduar në seancën plenare të Kuvendit për lexim të parë.

*Pas debatit, Komisioni më 6 gjashtë vota për nxori këtë:*

#### *Përfundim*

*1. Miratohet në parim Projektligji Nr.08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor;*

*2. I Rekomandohet Kuvendit të e miratojë në parim Projektligjin nr. 08/L-320 për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.*

### **3. Të ndryshme**

*Për pikën të ndryshme nuk pati ndonjë çështje për diskutim.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

**Fatmire Kollçaku,**

**Kryetare e Komisioni**

---

